



LIDHJA E ARSIMTARËVE DHE PRINDËRVE SHQIPTARË (LAPSH)
ALBANISCHER LEHRER UND ELTERNVERBAND (ALEV)
LIGUE DES ENSEIGNANTS ET DES PARENTS ALBANAIS (LEPA)
LEGA DEGLI INSEGNANTI E DEI GENITORI ALBANESI (LIGA)

NAIM FRASHËRI

GENÈVE

Raporti vjetor 2024

Lidhja e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë (LAPSH), Gjenevë

Kryesia (2024-2027)

Kryetar: Liburn Mehmetaj

Sekretar: Enver Nesushta

Anëtarët e Kryesisë:

- Brikena Osmani (përfaqësuese e mësueseve)
- Azem Hyseni
- Esena Aliraj
- Gentiana Kasemi
- Besnik Zeqiri
- Bajrush Sejdi

Mësueset:

- Lumnije Emini
- Fatime Bllaca
- Hyrije Kurteshi (pensionuar në fund të vitit 2024-2025)
- Hana Bilalli
- Brikena Osmani
- Antigona Haxhiu

Pikat kryesore

Nderime për mësuesen Hyrije Kurteshi

Në fund të vitit 2024-2025, mësuesja Hyrije Kurteshi doli në pension pas 25 viteve shërbimi, që nga viti 2000. E angazhuar sidomos në Onex, ajo ka lënë gjurmë te breza të tërë nxënësish me përkushtimin dhe dashurinë e saj për mësimdhënien e gjuhës dhe kulturës shqiptare. Një ceremoni lamtumire, e organizuar nga familja në prani të mësueseve dhe Kryetarit, i dha asaj nderimin e merituar.

Kryesia

Kryesia pësoi ndryshime të rëndësishme në vitin 2024, me një rinovim të plotë për periudhën 2024-2027. Ekipi i ri pasqyron një fazë të re angazhimi dhe stabiliteti.

Përbërja e Kryesisë 2024-2027: Liburn Mehmetaj (Kryetar), Enver Nesushta (Sekretar), Bajrush Sejdiq (Arkëtar), Brikena Osmani (përfaqësuese e mësuesëve), Azem Hyseni, Esena Aliraj, Gentiana Kasemi, Besnik Zeqiri.

TË NDIHMOJMË SHKOLLEN SHQIPE NË GJËNEVË

NDIHMO SHKOLLËN SHQIPE
DUKE DHURUAR NJË SHUMË
SIPAS DËSHIRËS

WWW.LAPSHGENEVE.COM/NDIHMO



- KONTABILITETI AUDITUAR DHE TRANSPARENT
- MBËSHTETUR NGA KANTONI DHE KOMUNAT
- KRYESIA PUNON PA PAGESË
- NXËNËS:



6 mësuese +210 nxënës 17 klasë



"Mbrotjtja e gjuhës është detyrë dhe peng nderi
për çdo shqiptar."

- Gjovalin Shkurtaj

Shpenzime
8%



Pagat e mësuesëve
92%

Kryesia: Liburn Mehmetaj (Kryetar), Enver Nesushta (Sekretar), Azem Hyseni (anëtar), Esena Aliraj (Anëtare), Bajrush Sejdiq (Arkëtar), Gentiana Kasemi (anëtare), Brikena Osmani (përfaqësuese e mësuesëve).

LAPSH, Ch. des Coudriers 21, 1216 Cointrin
lapshgeneve@gmail.com | +41 22 548 38 28

WWW.LAPSHGENEVE.COM



Donacionet dhe fushata e mbështetjes

Viti 2024-2025 u shënua nga një fushatë donacionesh jashtëzakonisht e suksesshme, e para e këtij niveli për LAPSH-in. Falë bujarisë së komunitetit, u siguruan mjete të rëndësishme për mbështetjen e projekteve arsimore të shoqatës. Lista e plotë e donatorëve gjendet në fund të raportit.

Ftesa në darkën shtetërore

Në vitin 2024-2025, Kryetari i LAPSH-it u ftua në darkën shtetërore të organizuar nga Këshilli Federal i Zvicrës në nder të Presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani. Kjo përfaqëson një vlerësim institucional për shkollën shqipe dhe rolin e LAPSH-it në kantonin e Gjenevës.



Klasa e re në Onex

Në vitin 2024 u hap klasa e re në Onex, nën drejtimin e mësueses Antigona Haxhiu. Me fillim modest prej 6 nxënësish, klasa u rrit në 18 nxënës deri në ditën e hartimit të raportit, duke treguar kërkesë reale dhe stabilitet të madh.



Festa e fundvitit 2023-2024

Festa e fundvitit u mbajt në Parc des Evaux, si një ditë e madhe sportive me shumë pjesëmarrje të fëmijëve dhe prindërve. Moti i mirë ndihmoi atmosferën e gëzueshme. Fotot do të shtohen më vonë.

Konferencat në shkollat e kantonit

Viti 2024 shënoi përmbylljen e një cikli të rëndësishëm konferencash të dedikuara një kuptimi më të mirë të nxënësve shqipfolës. Pas disa sesioneve të organizuara në shumë shkolla të kantonit, ky punim u kurorëzua me realizimin e një videoje zyrtare të regjistruar nga Shërbimi i Shkollave-Mediave.

Konferenca me titull «Të njohim më mirë nxënësit shqipfolës», e paraqitur nga Liburn Mehmetaj, u regjistrua në mënyrë profesionale:

2024-D1405 – «Të njohim më mirë nxënësit shqipfolës», regjistrim nga Alexandre Monnier (2024, 72')

Kjo video ofron një paraqitje të qartë dhe të kuptueshme të komunitetit shqiptar, kulturës së tij dhe veçorive që janë të rëndësishme për personelin arsimor. Siç shprehet Liburn Mehmetaj, nëse «ke dashur gjithmonë të dish gjithçka për shqiptarët pa guxuar ndonjëherë të pyesësh», atëherë kjo video është e pazëvendësueshme.

Shërbimi i Shkollave-Mediave e realizoi këtë prodhim me mandat të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit të Detyrueshëm të Departamentit të Arsimit Publik, të Formimit dhe të Rinisë, me synimin që ta bëjë kulturën shqiptare më të njohur për mësime të nxënësve të kantonit.

Festa kombëtare e 28 Nëntorit

Për herë të parë u organizua në Sallën Komunale të Onex-it, me një pjesëmarrje mbresëlënëse prej rreth **1200 personash**. Morren fjalën përshëndetëse: Znj. **Carole-Anne Kast** (Këshilltare e Shtetit) dhe Znj. **Floreta Kabashi** (Konsulle e Kosovës).





Artistët pjesëmarrës: Egzon Pireci (me Alban Bislimin), Fëmijët e LAPSH-it, Ansambli Gëzuar, Rinia Contact, Grupi Muzikor Hareja, Ejona Bytyqi, Florentina Statovci, LMN – Elion Krasniqi, Bardh Ramadani, Loik Beka, Afërdita & Shpejtim Krasniqi.

Organizatorët:

LAPSH

Komuniteti Shqiptar i Gjenevës

Rinia Contact

Shoqata e Studenteve Shqiptarë të Gjenevës

Shoqata Zhegra.

Numri i nxënësve

Viti 2024-2025 regjistroi **223 nxënës**, duke reflektuar rritjen dhe stabilitetin e shkollës.

Klasat

Klasa	Mësuesja	Nxënës
LE CORBUSIER	Brikena Osmani	17
EUROPE	Brikena Osmani	17
CENTRE QUARTIER CHATELAINE	Brikena Osmani	17

Klasa	Mësuesja	Nxënës
LA TOUR	Brikena Osmani	16
THÒNEX BOIS-DES-ARTS	Brikena Osmani	12
PALETTES	Fatime Bllaca	10
SAPAY	Fatime Bllaca	13
PLATEAU	Fatime Bllaca	9
MAIL	Fatime Bllaca	12
MEYRIN-GOLETTE	Hana Bilalli	12
MAISON ONESIENNE	Hyrije Kurteshi	14
AIRE	Lumnije Emini	9
AVANCHETS-SALEVE	Lumnije Emini	16
COLOMBIERES-VERSOIX	Antigona Haxhiu	6
PERVENCHES-CAROUGE	Lumnije Emini	15
MASION ONESIENNE II	Antigona Haxhiu	6
EMILIE DE MORSIER	Lumnije Emini	22

Komunikimi

Facebook

Faqja zyrtare arriti **1062 ndjekës** në vitin 2024-2025, duke treguar interes të qëndrueshëm të komunitetit.

Faqja e internetit

Gjatë vitit 2024-2025, faqja e LAPSH-it regjistroi **20 851 vizita unike**, duke mbetur një mjet qendror komunikimi për prindërit dhe mësueset.

Pasqyrat financiare

Pasqyrat financiare figurojnë në aneks.

Bashkëpunimet

Departamenti i Arsimit Publik (DIP)

Bashkëpunimi ka vazhduar në kuadër të projektit FESEA, ku LAPSH ka kontribuar me:

- seanca informuese për prindërit;
- koordinim të rregullt me ekipet arsimore;
- përdorimin e një platforme mobile për raportimin e aktiviteteve.

Zyra e Integrimit dhe Qytetarisë (BIC)

Mbështetja mbetet e pandryshuar, me një subvencion prej **35 000 CHF**.

Komunat

Bashkëpunimi mbetet stabil me komunat: Gjenevë, Carouge, Grand-Saconnex, Lancy, Meyrin, Onex, Plan-les-Ouates, Thônex, Vernier dhe Versoix. Risi është hapja e klasës së re në Onex.

Komunat

Bashkëpunimi mbetet stabil me komunat: Gjenevë, Carouge, Grand-Saconnex, Lancy, Meyrin, Onex, Plan-les-Ouates, Thônex, Vernier dhe Versoix. Risi është hapja e klasës së re në Onex.

Të gjitha komunat i kanë ofruar shoqatës falas klasat e tyre - dhe ne i falënderojmë për këtë.

Shoqatat partnere

LAPSH ka ruajtur bashkëpunim të shkëlqyer me shoqatat lokale shqiptare.

GEplurilingue

Pjesëmarrja e LAPSH-it ka vazhduar edhe në kuadër të projektit FESEA.

Auditori i kontabilitetit

Michael Jean-Mairet (Tannhaus)

Falënderime

Si Kryetar i LAPSH-it, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të veçantë për **Enver Nesushtën**, sekretar i shoqatës, për punën e tij të jashtëzakonshme në terren.

Falënderoj me zemër të gjitha mësueset për përkushtimin dhe punën e tyre të palodhur.

LAPSH-Gjenevë shpreh mirënjohjen e saj për institucionet që kanë mbështetur realizimin e qëllimeve tona:

- **Departamenti i Arsimit Publik (DIP)**, veçanërisht Znj. Claire de Goumoëns
- **BIC – Zyra e Integritetit dhe Qytetarisë**, veçanërisht Znj. Mathilde Maradan
- **Ambasada e Kosovës në Zvicër**, Ambasadori Mentor Latifi dhe Konsulen Floreta Kabashi
- **Komunat e kantonit të Gjenevës**: Gjeneva, Carouge, Grand-Saconnex, Lancy, Meyrin, Onex, Plan-les-Ouates, Thônex, Vernier, Versoix

Donatorët tanë

Falë kësaj fushate mbështetjeje jashtëzakonisht të suksesshme, u mbledhën mbi 9 500 CHF për të përkrahur aktivitetet arsimore të LAPSH-it. Shoqata shpreh mirënjohjen e saj të përzemërt për donatorët në vijim:

Donatorët			
Hekuran Pira	Nicolas Berchier	Hyseni Constructions SA	Hysimmo Invest SA
Pierre Hagmann – Menuiserie Agencements SA	Butrint Ajredini	Ilir Cenko	Gonxhe Idrizi
Ariana Hajdini Sefiu	Durim Emini	Shoqata humanitare Halil Jahiu	Betim Bilalli
Eliza Ibrahimaj	Pranvera Këllezi	Sali Salihu	Nathalie Strasser
Sami Gashi	Sandra Birchier Micheli	Njazi Brahimi	Astrit Buja
Xavier Fernandez	FS Projets Sàrl	David Garcia	Ajet Hyseni
Granit Molliqaj	Nasuf Nuhiu	Anne-Marie Parini	Alkis Passas
Pierre-Antoine Rieben	Ukshin Ukshini	Ferid Zeqiri	Ermal Aliraj
Etienne Anex	Münür Aslan	Véronique Castella	Bernard de Rovinelli
François El Assad	Donjete Emini	Drilon Gashi	Besarta Mehmetaj
Ilirian Morina	Qendrim Nebiu	Arjan Nuhiu	Olivier Sigg

Donatorët			
Dennis Winkler	Avni Salihu	André Python	Jon Stojkaj

Informata

LAPSH

Ch. des Coudriers 21

1216 Cointrin

Tel. 022 548 38 28

www.lapshgeneve.com

Gjenevë, nëntor 2024

Liburn Mehmetaj, Kryetar

Me mbështetjen e:

